

Syllabus i lëndës

Lënda: Zhvillimi i kulturës islame në Ballkan

Programi i studimit: Teologji islame

Numri i ECTS kredive: 5 ECTS kredi

Lloji i lëndës: Zgjedhore

Kodi i lëndës:

Numri i orëve: 2 + 1

Semestri:

Profesori i lëndës: Prof. Asoc. Dr. Sadik Mehmeti

Kontakti: sadikmehmeti72@hotmail.com

Përmbledhje e shkurtër e lëndës:

Njohje me zhvillimin e kulturës islame në Ballkan, me një interesimi të veçantë për zhvillimin e kulturës islame në trojet shqiptare. Me sintagmën “kulturë islame” nënkuptohet tërë prodhimi i mendjes, shpirtit dhe duarve të popujve të Ballkanit, që është krijuar në frymën e sistemit kulturor dhe civilizues islam, që nga periudha kur hapësirat gjeo-etnike të Ballkanit u gjendën në rrezën e ndikimit të kulturës dhe qytetërimit islam. Njohja e zhvillimit të kulturës islame në Ballkan, synon të kontribuojë si dhe ndihmon në ndriçimin e historisë së kulturës së përgjithshme të kësaj hapësire dhe të këtyre popujve.

Qëllimi i lëndës

Me këtë studim synojmë të hetojmë dhe të konstatojmë rrugën e zhvillimit të kulturës islame në Ballkan. Këtu përfshihen të gjitha segmentet përmbajtjesore të kulturës lëndore (materiale) dhe, sidomos, të kulturës mendore e shpirtërore të popujve të kësaj hapësire, me ndikime islame, si arkitekturën sakrale dhe profane, institucionet kulturore arsimore dhe fetare, letërsinë, folklorin dhe gjuhën. Megjithatë, boshtin kryesor të këtij studimi e përbëjnë elementet kulturore, si letërsia, dhe institucionet kulturore arsimore dhe fetare të kësaj periudhe.

Për të krijuar një përfytyrim sa më të përafërt për procesin zhvillimor të kulturës islame, dhe për të rindërtuar në mënyrë më të plotë shkencore këtë proces, doemos mbështjettja kryesore bëhet mbi bazën e të dhënave historike, të materialeve dokumentare gjuhësore e letrare dhe të fakteve etnografike e antropologjike.

Rezultatet e pritura të nxënies:

Pas përfundimit të këtij cikli të ligjëratave studenti do të jetë në gjendje që:

- Të shpjegoj fillet dhe etapat e zhvillimit të kulturës islame në Ballkan
- Të shpjegoj fillet dhe etapat e zhvillimit të kulturës islame me theks të veçantë në trojet shqiptare.
- Të njoh bartësit kryesor të kulturës lëndore (materiale) dhe shpirtërore me ndikime islame të popujve të kësaj hapësire,
- Të njoh institucionet kulturore - arsimore dhe fetare, letërsinë, folklorin etj..
- Të paraqes në mënyrë objektive dhe të paanshme ndikimin e kulturës islame tek popujt e kësaj hapësire.

Të diskutoj për vendin e kulturës islame në mesin e kulturave të tjera tek popujt e Ballkanit.

Metodologjia e mësimdhënies:

- Mësimdhënia do të zhvillohet në formën e ligjëratave.
- Në nxitjen dhe provokimin e debateve ndër studentët.
- Me përfshirjen e studentëve në diskutime.
- Përmes punimeve të seminareve dhe kollokfiumeve.

Përmbajtja e lëndës:

Java I:

Paraqitje e përgjithshme për lëndën. Njohja me detajet themelore dhe pasqyrën e lëndës, kuptimi dhe rëndësia e lëndës.

Java II

Kuptimi i nocioneve kulturë dhe kulturë islame (përkufizimet për kulturën; përkufizimet për kulturën islame.

Literatura: Jëllmaz Ozakpënar, *Kultura dhe qytetërimi-një teori mbi qytetërimin*, Logos A, Shkup, 2003, f. 13-40).

Java III

Fillet e përhapjes së fesë islame, përkatësisht të kulturës islame në Ballkan.

Literatura: Tomas Arnold, *Historia e përhapjes së Islamit*, botoi: Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosoëvs, Prishtinë, 2006; Karen Arsmstrong, *Islami-një histori e shkurtër*, Shkup, 2001.

Java IV

Sfondi historik mbi të cilin është paraqitur dhe është zhvilluar kultura islame në Ballkan.

Literatura: Muhamet Pirraku, *Kultura Kombëtare shqiptare deri në Lidhjen e Prizrenit*, IAP, Prishtinë 1989.

Java V

Rrethanat shoqërore-ekonomike dhe politike, si faktorë përcaktues të zhvillimit të kulturës islame.

Literatura: Muhamet Pirraku, *Kultura Kombëtare shqiptare deri në Lidhjen e Prizrenit*, IAP, Prishtinë 1989.

Java VI

Themelimi i institucioneve arsimore, edukative dhe kulturore, mejtepet, medresetë, bibliotekat si dhe funksioni arsimor edukativ i xhamive dhe teqeve.

Literatura: Prof. dr. Ziya Kazeci, *Historia e arsimit islam*, Tiranë, 2001, f.33-60.

Java VIII

Shkollat e mesme dhe të lartë islame- medresetë si bartës kryesor të zhvillimit të arsimit dhe kulturës islame në Ballkan; medresetë më të njohura në këto vise.

Literatura: Ekmeludin Ihsanoglu, *Institucionet studimore shkencore dhe arsimore osmane*,

kapitulli VIII, në: “Historia e shtetit, shoqërisë dhe qytetërimit islam”, vëllimi I, Tiranë, 2009, f. 369-457; Ramiz Zeka, *Zhvillimi i kulturës islame te shqiptarët gjatë shekullit XX*, Tiranë, 2009.

Java IX

Letërsia me ndikime islame e popujve të Ballkanit.

Literatura: Mahmud Hysa, *Letërsia Alamiado, I-II*, Logos A, Shkup, 2001; Muhamet Pirraku, *Kultura Kombëtare shqiptare deri në Lidhjen e Prizrenit*, IAP, Prishtinë 1989.

Java X

Zhvillimi i urbanistikës dhe arkitekturës së objekteve sakrale dhe arkitekturës së objekteve profane me elemente islame.

Literatura: Aleksander Meksi, *Arkitektura e xhamive në Shqipëri*, Tiranë, 2006.

Java e XI

Monumente të kulturës islame në Ballkan

Literatura: Iljaz Rexha, *Monumente të kulturës islame të shek XV – XVI në Kosovë*, “Edukata Islame”, nr. 75, Prishtinë, 2004

Java XII

Pasqyrimi i kulturës popullore me ndikime islame. Format dhe llojet e ndryshme të kulturës popullore, si: poezia popullore, proza popullore, arkitektura popullore, veshja dhe ushqimi, si dhe besimi popullor.

Literatura: Muhamet Pirraku, *Kultura Kombëtare shqiptare deri në Lidhjen e Prizrenit*, IAP, Prishtinë 1989.

Java XIII

Personalitete dhe figura të shquara dhe ndikimi i tyre në zhvillimin e kulturës islame
Literatura: Muhamet Pirraku, *Kultura Kombëtare shqiptare deri në Lidhjen e Prizrenit*, IAP, Prishtinë 1989.

Java XIV

Periodiku dhe literatura e botuar fetare islame

Literatura: Fahrush Rexhepi, *Periodiku shqiptar islam*, Prishtinë, 2013; Përmbledhje kumtesash nga sesioni shkencor: *Shtypi islam, dje sot dhe nesër*, Prishtinë, 2005.

Java e XV

Përmbledhje e ligjëratave dhe seminarëve

Kriteriumi dhe komponentet e vlerësimit:

Pjesëmarrje dhe angazhimi në ligjëratë 10%

Punimi seminarik 20%

Testi intermedier 30%

Provimi final 40%

Total 100%

Literatura themelore- obliguese:

1. Muhamet Pirraku, *Kultura Kombëtare shqiptare deri në Lidhjen e Prizrenit*, IAP, Prishtinë 1989
2. Nehat Krasniqi, *Kontribute albanologjike (studime dhe dokumente historike e letrare të periudhës osmane)*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë, 2010.

Literatura opsionale:

1. Tomas Arnold, *Historia e përhapjes së Islamit*, botoi: Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë, 2006.